

## A je bërë objekt i dhunës në një lidhje të afërt?

Dhuna në lidhje të afërt mund të jetë më shumë gjëra. Ndonjëherë është një partner që të bën ty objekt. Ndonjëherë janë të tjerët nga farefisi. Po ashtu, mund të jenë edhe fëmijët që i bëjnë objekt prindërit e tyre. Dhuna mund të jetë si dhunë psikike, fizike dhe seksuale. Kjo mund të jetë kur dikush:

- Të quan ty të keq/keqe dhe të ligë ose ti mund të dëgjosh se ti je i keq/e keqe dhe e bezdisshme.
- Të shtynë, godet, shqelmon ose të lëndon në ndonjë mënyrë tjetër
- Të kontrollon dhe të kufizon, të detyron të bësh gjëra që ti nuk dëshiron t'i bësh
- Të detyron ty të përshtatësh sjelljen tënde ose të ndryshosh stilin tënd të jetës
- Të detyron të bësh diçka seksualisht
- Merr kontrollin e ekonomisë tënde

### Ti ke të drejtë për mbrojtje dhe për mbështetje

Çdokush mund të goditet nga dhuna në një lidhje të afërt. Ti që je bërë objekt do të marrësh informacion, mbrojtje dhe mbështetje dhe do të pranohesh me respekt dhe me ndjeshmëri. Ke të drejtë për këtë gjë. Nëse ke fëmijë, në atë rast edhe fëmijët kanë të drejtë për mbështetje.

### Ti mund të kesh ndihme me:

- Biseda mbështetëse
- Mbrojtje dhe banim të përkohshëm
- Ndihmë ekonomike
- Mbështetje në kontaktet me organet e tjera zyrtare, p.sh. policinë.

Na kontakto ne që të ndihmojmë ty. Nëse ti dëshiron, ti mund të jesh anonim.

Në rast të rrezikut akut, telefono gjithmonë 112.

### Kontakto:

- **Veprimtarinë:** Socialtjänsten Vårgårda
- **Numri i telefonit:** Telefon växel 0322-600 617
- **Uebfaqja:** [www.vargarda.se](http://www.vargarda.se)
- **Adresa e selisë/vizitës:** Kungsgatan 45